

**Akt themelimi i shoqerise**  
**"GTS - GAZRA TEKNIKE SHQIPTARE - Sh.p.k."**

Ne Tirane, sot me 18 janar 1996, Z.Giovanni Annoni, lindur ne Livorno me 21.01.1959 dhe banues ne Monza ne Via Q.e Sella, n.5, dhe Z.Giulio Fumagalli Romario, lindur ne Campiglia Marittima (LI) me 11.11.1964 dhe banues ne Monza ne Via Zucchi, n.21, ne baze te Prokures se Posaçme e cila i autorizon qe ne emer dhe per llogari te shoqerise SOL SpA, me seli ne Monza, Piazza Diaz, n.1, me kapital Lira italiane 64.000.000.000, te regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive prane Gjykates se Monzes me n.14.920, me kod fiskal n.04127270157, te veprojne sebashku apo veçmas per te themeluar ne Shqiperi nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Tirane, te quajtur GTS-Gazra Teknike Shqiptare Sh.p.k., me nje kapital prej 5.000.000 Leke, Prokure me numer 352011, e nenshkruar perpara noterit me date 09.01.1996,, nga Inxh.Giulio Francesco Fumagalli Romario, lindur ne Monza (MI) me 05.09.1926, ne cilesine e Presidentit dhe te Administratorit te Deleguar te SOL SpA,

**themeluan**

**Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar:**  
**GTS-Gazra Teknike Shqiptare-Sh.p.k.,**

e cila do te zhvilloje aktivitetin e saj ne baze te ligjit shqiptar ne fuqi dhe te Statutit bashkemgjitur.

Shoqeria GTS-Gazra Teknike Shqiptare-Sh.p.k.ka nje kapital prej: Leke Shqiptare 5.000.000 (pese-milion)te nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga Shoqeria SOL SpA qe eshte Ortak i Vetem i kesaj shoqerie.

Selia e shoqerise eshte:

prane Studios Pustina, ne adresen Bul. "Shqiperia e Re", Pall." 1 Maji", Shk. 9, Ap. 24, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape filiale dhe zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte saj.

Gjithashtu zyra perfaqesimi dhe filiale mund te hapen dhe jashte territorit shqiptar dhe do ti nenshtrohen legjislacionit te shtetit ku ndodhen.

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete:

99 vjet duke filluar nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregtar dhe shoqeria ruan te drejten e zgjatjes se kesaj periudhe si dhe te shperndarjes se parakohshme me vendim te Ortakut te Vetem sipas ligjit.

Shoqeria administrohet nga nje:

Keshill Administrativ i perbere nga dy anetare (administratore) te emeruar nga Ortaku i Vetem dhe qe qendrojne ne detyre per nje

SA

periudhe prej tre vitesh financiare, deri ne ditën e paraqitjes se bilancit vjetor te vitit te trete.

Emerohen anetare te Keshillit Administrativ (administratore):

Z.Giovanni Annoni, lindur ne Livorno me 21.01.1959 dhe banues ne Monza ne Via Q.e Sella, n.5, dhe

Z.Giulio Fumagalli Romario, lindur ne Campiglia Marittima (LI) me 11.11.1964 dhe banues ne Monza ne Via Zucchi, n.21,

Z.Giovanni Annoni eshte Perfagesuesi ligjor i Shoqerise ndaj te treteve dhe organeve gjyqesore, dhe mund te ndermarre çdo iniciative perpara instancave gjyqesore dhe administrative te çfaredo shkalle dhe vendi, vete apo nepermjet avokateve ose te treteve te porositur me prokure.

**Ky Akt Themelimi nenshkruhet nga Z.Giovanni Annoni dhe Z.Giulio Fumagalli Romario ne prani te Noterit Halim ISLAMI.**

GIULIO FUMAGALLI ROMARIO  
Giulio Fumagalli Romario

GIOVANNI ANNONI

Giovanni Annoni

Republika e Shqipërisë

Noteria

Nr. 17 Rep

Nr. 26 Ksh.

Tirane, 18.06.88

Vertetuar

Vertetohen format e Giovanni Annoni & sh.  
Giulio Fumagalli, te rena ne keto dokument  
pore meje.

Noteri:

Halim Islami

HI



**Statuti i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar  
"GTS GAZRA TEKNIKE SHQIPTARE SH.P.K.**



EMERTIMI - FORMA - BAZA LIGJORE

**Neni 1**

Ortaku themelues shoqeria SOL SPA, me seli ne Itali, Monza (MI ), Piazza 1 ka themeluar nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar nen emertimin "GTS Gazra Teknike Shqiptare" Sh.p.k.

**Neni 2**

Shoqeria fiton zotesine juridike pas vendimit te Gjykates se Tiranes.

**Neni 3**

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe me dispozitat e Statutit dhe te Aktit te Themelimit.

OBJEKTI - SELIA

**Neni 4**

Shoqeria ka si objekt aktiviteti prodhimin, shitjen, tregtimin e gazit teknik, terapeutik dhe gazrave te tjere, pa perjashtuar prodhimin e aparaturave qe kane te bejne me to; projektimin, realizimin dhe instalimin e impjanteve te lidhura me gazin e siperpermendur, perfshire ketu dhe projektimin, realizimin e instalimin e impjanteve elektrike te domosdoshem per funksionimin e tyre; kryerjen e sherbimeve lidhur me sa me siper dhe kryerjen e transportit te mallrave qofte dhe per llogari te te treteve. Shoqeria mund te leshoje garanci te çdo lloji ne favor te te treteve, per detyrime dhe borxhe te tyre, qofte dhe kur nuk jane ortake; gjithashtu mund te kryeje çdo operacion tregtar, industrial dhe financiar, te tundshen dhe te patundshem qe organi administrativ do te konsideroje te nevojshme per permbushjen e objektit te aktivitetit te shoqerise; gjithashtu shoqeria, drejtpersedrejti ose indirekt, mund te marre pjese apo te likujdoje pjesemarrjen ne shoqeri te tjera te formuara ose qe jane duke u formuar ne Shqi peri apo jashte saj, me objekt aktiviteti te ngjashem apo te lidhur me te sajin, si dhe te realizoje koordinimin teknik, organizativ e financiar te shoqerive te tjera. Ndalohet kryerja nga shoqeria e çdo aktiviteti ndermjetesimi.

67R  
SA

**Neni 5**

Shoqeria "GTS Gazra Teknike Shqiptare" SH.P.K. ka seline prane Studios Pustina, ne adresen Bul. "Shqiperia e Re", Pall." 1 Maji", Shk. 9, Ap. 24, Tirane, Shqiperi.

**Neni 6**

Adresa zyrtare e Ortakeve ne raport me Shoqerine eshte selia e saj.

**Neni 7**

Shoqeria mund te hape filiale dhe zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte saj. Gjithashtu zyra perfaqesimi dhe filiale mund te hapen dhe jashte territorit shqiptar dhe do ti nenshtrohen legjislacionit te shtetit ku ndodhen.

**KOHEZGJATJA - KAPITALI**

**Neni 8**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe 99 vjeçare duke filluar nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregtar dhe ruan te drejten e zgjatjes se kesaj periudhe si dhe te shperndarjes se parakohshme me vendim te Ortakut te Vetem sipas ligjit.

**Neni 9**

Kapitali i shoqerise eshte 5.000.000 lek shqiptare dhe shlyhet plotesisht ne te holla.

**Neni 10**

Kuotat transferohet sipas ligjit ne fuqi.

**Neni 11**

Shoqeria i pergjigjet detyrimeve karshi te treteve deri ne vleren e kapitalit te saj.

*Handwritten initials/signature*



ORGANET E SHOQERISE - ORTAKU I VETEM

**Neni 13**

Keshilli Administrativ perbehet nga dy anetare (administratore) te emeruar nga Ortaku i Vetem.

Perfaqesimi ligjor i Shoqerise ndaj te treteve dhe organeve gjyqesore do te behet nga me i vjetri ne moshe nga anetaret e Keshillit Administrativ, dhe ky i fundit mund te ndermarre çdo iniciative perpara instancave gjyqesore dhe administrative te çfaredo shkalle dhe vendi, vete apo nepermjet avokateve ose te treteve te porositur me prokure.

Anetaret e Keshillit Administrativ mbajne secili me vete te gjitha funksionet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te administrimit te shoqerise; behet perjashtim kategorik nga sa me siper vetem per aktet e percaktuara shprehimisht me poshte, per kryerjen e te cileve dy anetaret e Keshillit Administrativ operojne sebashku dhe me firma te bashkengjitura, ne te kundert behet i domosdoshem leshimi i nje prokure te posaçme perpara noterit nga njeri prej anetareve te Keshillit Administrativ ne favor te tjetrit:

- pranimi, leshimi, perftimi i kambialeve;
- dhenia e garancive qe e kalojne vleren 12.000.000 leke;
- blerja, shitja, shkembimi i pasurive te paluajtshme te Shoqerise;
- blerja apo shitja e impianteve industriale qe kalojne vleren 24.000.000 leke;
- nenshkrimi i kontratave per "leasing" qe kalojne vleren 24.000.000 leke;
- dhenia me qira e sendeve te palujtshme apo impianteve industriale te Shoqerise;
- venia e hipotekave apo garancive te tjera reale mbi pasurite e Shoqerise;
- marrja apo pranimi i kredive nga institute bankare apo nga çdo lloj financuesi tjetër;
- emerimi i drejtoreve te Shoqerise;

Ne funksionet e administrimit te zakonshem te Shoqerise hyjne shprehimisht:

- kerkimi dhe terheqja e kredive te akorduara nga Shoqeria ndaj te treteve private, shoqeri, persona morale, komuna e bashki, ente publike, gjysme-publike apo te ngjashem, pa asnje perjashtim, te çfaredo vlere apo lloji qofshin, duke leshuar gjithashtu deklaratat apo vertetimet e nevojshme per te provuar shlyerjen e ketyre kredive;
- terheqja ne menyre te perseritur apo ne çfaredo menyre tjetër, e shumave te depozituara ne llogarite bankare te Shoqerise apo

SPR  
SA



- e shumave te akorduar ne favor te Shoqerise nga bankat dhe qe jane pranuar me pare me firme te perbashket te dy anetareve te Keshillit Administrativ, qofte dhe nepermjet çeqeve te emetuar nga Shoqeria apo te leshuar ne emer te saj;
- çelja e letrave te kreditit te thjeshta apo dokumentare kundrejt pageses dhe pranimit, me mundesine e leshimit te garancive deri ne vleren 12.000.000 leke;
  - xhirimi dhe thyerja e çeqeve mbi llogarite rrjedhese apo çeqeve qarkullues te cilitdo instituti bankar, mandat-pagesave postare apo telegrafike apo çdo lloj titulli tjeter ne emer te pruresit;
  - derdhja dhe terheqja e depozitave per efekt garancie te çfaredo lloji;
  - xhirimi prane instituteve bankare i kambialeve apo çdo titulli tjeter te konvertueshem;
  - blerja dhe shitja e automjeteve dhe kryerja e te gjitha procedurave relative;
  - blerja e sendeve te tundshme ne funksion te aktivitetit te Shoqerise deri ne vleren 24.000.000 leke;
  - pranimi i kontratave per "leasing" deri ne vleren 24.000.000 leke;
  - nenshkrimi i kontratave per furnizim me energji elektrike, uje apo gaz metan;
  - pjesemarrja ne gara e tender-a;
  - kryerja e tratativave;
  - paraqitja e ofertave per shitjen e gazrave apo materialeve e prodhimeve te tjera perpara privateve, shoqerive, personave morale, komunave e bashkive, enteve publike, gjysme-publike apo te ngjashem, spitaleve apo çdo administrate publike tjeter, pa asnje perjashtim, me te drejten e nenshkrimit te kontratave relative dhe percaktimit te kushteve kontraktore;
  - nenshkrimi dhe perpilimi i çdo deklarate apo detyrimi tjeter fiskal sipas ligjit shqiptar ne fuqi.

#### **Neni 14**

Administratoret qendrojne ne detyre per nje periudhe prej tre vitesh financiare, deri ne ditën e paraqitjes se bilancit vjetor te vitit te trete.

#### **Neni 15**

Administratoret jane pergjegjes individualisht apo solidarisht ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve per çdo shkelje te ligjit apo te statutit te Shoqerise.

*JFE*  
*SA*



Administratoret mund te shkarkohen ne çdo moment me vendim te Ortakut te Vetem. Shkarkimi i tyre duhet te jete i motivuar.

EKSPERTI KONTABEL

**Neni 17**

Eksperti kontabel do te caktohet ne rastet kur ligji e ben te detyrueshme pranine e tij dhe do te zhvilloje aktivitetin ne perputhje me ligjet ne fuqi.

**Neni 18**

Ortaku i Vetem verifikon llogarite e Shoqerise nepermjet raportit te Keshillit Administrativ ose nepermjet raportit te ekspertit kontabel te emeruar prej tij, dhe brenda gjashte muajve duke filluar nga mbyllja e vitit financiar aprovon bilancin dhe vendos mbi shperndarjen e fitimeve pas derdhjes se fondit rezerve.

**Neni 19**

Vendimet e Keshillit Administrativ mbahen ne nje liber te posaçem. Raportet e administrimit, inventaret dhe llogarite hartohen nga administratoret dhe i paraqiten Ortaku te Vetem qe merr vendimet relative.

**Neni 20**

Viti financiar fillon çdo 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar do te filloje ditën e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbyllet me 31 dhjetor 1996.

**Neni 21**

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nga kontrata pune te hartuara ne baze te ligjit shqiptar.

**Neni 22**

Ortaku i Vetem cakton likuidatorin apo likuidatoret dhe menyren e

GA  
JA



likuidimit te Shoqerise mbi bazen e ligjit shqiptar ne fuqi.

Neni 23

Ky statut i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte i hartuar ne pese ekzemplare ne shqip dhe tre ne italisht, qe te dy me te njeten vlere.

GIULIO FUNDOSHI RONAPPO  
Giulio Fondoshi Ronapo

GIOVANNI ANNONI

Giovanni Annoni

Republika e Shqiperise  
Notaris  
Nr. 16 Rep  
M. 25/1986

Tiranë, 18.01.86

Vërtetur

Vërtetohen format e Gornave Annoni dhe  
Ornditje formo, te veno ne kete dokument  
me formen ture.

Notari:  
Adulbiloj.

SH

